



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA


MINISTRIA E ARSIMIT E
SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË
KQSHM

MINISTARSTVO OBRAZOVANJA
NAUKE I TEHNOLOGIJE

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY
DVSM

TESTI I MATURËS

**GJIMNAZI
SHKENCA SHOQËRORE**



Prishtinë, 23 qershor 2012

Emri dhe mbiemri i nxënësit


Shkolla.....

Udhëzime:

Koha: Keni 180 minuta që t'u përgjigjeni 80 kërkesave (pyetjeve). Koha numërohet prej momentit kur do të filloni t'i zgjidhni kërkesat.

Si të veproni?

1. Plotësojini me kujdes, sipas udhëzimeve, të gjitha kodet (në rreth), për: komunën, shkollën, paralelen, numrin e ditarit. Nëse këto të dhëna nuk i plotësoni saktë, nuk do të mund të nxirret rezultati i testit tuaj.
2. Para se të filloni t'u përgjigjeni pyetjeve, qetësohuni plotësisht, sepse kjo do t'ju ndihmojë.
3. Lexojini me kujdes kërkesat dhe pastaj shënojeni vetëm përgjigjen e saktë, nga 4 mundësitë e dhëna, për të cilën besoni se është e saktë.
4. Fleta e përgjigjeve duhet të plotësohet vetëm me laps të thjeshtë - laps HB.
5. Mbusheni kodin (në rreth) e përgjigjes së saktë me laps të thjeshtë, pa e shkarravitur jashtë. Shih shembullin e mëposhtëm.



6. Kini kujdes që përgjigjen e saktë të një pyetjeje të mos ia vendosni pyetjes tjetër të radhës.
7. Në Fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
8. Përgjigjet e sakta plotësohen njëkohësisht – në Test dhe në Fletën e përgjigjeve.
9. Çdo lloj llogaritjeje mund ta bëni në faqen e fundit të testit, ndërsa në fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve, për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
10. Mos humbni kohë me pyetjet që nuk i dini, sepse koha mund të mos ju mjaftojë për pyetjet e tjera.
11. Përdoreni deri në fund kohën e testimit, në mënyrë që t'u përgjigjeni të gjitha pyetjeve.

HISTORI

1. Me Zbulimet e mëdha gjeografike qendra e tregtisë evropiane u zhvendos nga Deti Mesdhe në Oqeanin Atlantik. Cilat qytete evropiane pësuan dëme nga kjo zhvendosje rrugëve tregtare?
 - A. Londra dhe Parisi
 - B. Madridi dhe Lisbona
 - C. Venediku, dhe Gjenova
 - D. Amsterdami dhe Dablina

2. Për forcimin e cilave ndryshime në shoqërinë evropiane ndikoj Lëvizja e reformacionit?
 - A. Forcimin e klasës së lartë dhe shtetit të papës
 - B. Forcimin e klasës së mesme dhe zhvillimin e arsimit
 - C. Forcimin e klasës feudale dhe zhvillimin e artit
 - D. Forcimin e klasës skllavopronare dhe sistemit bankar

3. Çka nënkuptohet me radhitjen e ngjarjeve historike sipas rendit kronologjik?
 - A. Radhitjen e ngjarjeve nga më të lashtat deri të më të rejtat
 - B. Radhitjen e ngjarjeve nga më të rejtat deri të më të lashtat
 - C. Radhitjen e ngjarjeve nga më të voglat deri të më të mëdhajat
 - D. Radhitjen e ngjarjeve nga më të mëdhajat deri të më të voglat

4. Ligjet e mbretit Hamurab të Mesopotamisë ishin të ashpra dhe diskriminuese për:
 - A. Zezakët
 - B. Feudalët
 - C. Aristokratët
 - D. Skllavërit

5. Çka realizoi Operacioni luftarak i datës 6 qershor 1944 i njohur me emrin "Overlord" (Zotëruesi)?
 - A. Zbarkimin e forcave ruse në Çeçeni
 - B. Sulmin e gjermanëve mbi Rusinë
 - C. Zbarkimin e forcave aleate në Normandi
 - D. Sulmin e gjermanëve mbi Anglinë


6. Janë dhënë pohimet:
 - I. Në Konferencën e Paqes në Paris problemi i Shqipërisë u diskutua gjatë por në përgjithësi kërkesat e shqiptarëve nuk u përfillën.
 - II. Në Konferencën e Paqes në Paris problemi i Shqipërisë u diskutua gjatë dhe kërkesat e shqiptarëve u përfillën nga evropianët
 - III. Në Konferencën e Paqes në Paris problemi i Shqipërisë u diskutua gjatë por kërkesat e shqiptarëve u përfillën vetëm nga italianëtCili nga pohimet e dhëna është i saktë:
 - A. Vetëm I
 - B. Vetëm II
 - C. Vetëm III
 - D. I, II dhe III

- 7.** Federata Jugosllave ishte një krijesë artificiale shtetërore e dominuar nga serbët dhe përbehej nga disa republika dhe krahina autonome. Nga sa republika dhe krahina përbehej federata jugosllave?
- Nga dy republika dhe gjashtë krahina
 - Nga pesë republika dhe tri krahina
 - Nga tri krahina dhe pesë republika
 - Nga gjashtë republika dhe dy krahina
- 8.** Në Kongresin e Elbasanit (1909) përveç vendimit për hapjen e shkollës pedagogjike cili ishte vendimi tjetër i aprovuar?
- Krijimi i një shoqërie qendrore që do të kujdesej për shkolla
 - Krijimi i Ministrisë së Arsimit që do të kujdesej për shkolla
 - Krijimi i shkollave të veçanta për vajza
 - Krijimi i shkollave speciale për fëmijë me të meta
- 9.** Lufat e Parë Botërore pati si shkas:
- Kongresin e Berlinit
 - Krizën Lindore
 - Atentatin e Sarajevës
 - Atentatin e Zagrebit
- 10.** Përveç Anglisë cilat shtete gjatë Luftës së parë Botërore bënë pjesë në Bllokun e Antantës?
- Perandoria Osmane, Bullgaria, Austria
 - Franca, Rusia, Italia
 - Shqipëria, Perandoria Osmane, Hungaria
 - Maqedonia, Shqipëria, Perandoria Osmane
- 11.** Më 1844 ministri serb Ilija Garashanin shpalli projektin e quajtur "Naçertania". Çka parashihet ky projekt në mes tjerash?
- Përfshirjen e trevave shqiptare në kuadër të Serbisë
 - Përfshirjen e trevave greke në kuadër të Serbisë
 - Bashkimin e Shqipërisë me Serbinë
 - Bashkimin e Serbisë me Kroacinë
- 12.** "Për të shqyrtuar problemet politike në Ballkan veçmas ato që nxori Lufta e Parë Ballkanike, gjashtë Fuqitë e Mëdha organizuan Konferencën e cila u drejtua nga ministri Eduard Grej. Problemi më i vështirë që u diskutua në Konferencë ishte caktimi i kufijve të Shqipërisë"
- Për cilën Konferencë bëhet fjalë në tekstin e lartëshënuar?
- Konferencën e Uashingtonit
 - Konferencën e Romës
 - Konferencën e Parisit
 - Konferencën e Londrës

- 13.** Përveç Holandës, Belgjikës, Danimarkës dhe Luksemburgut cilat shtete e në vitin 1951 formuan Komitetin Evropian që i parapriu formimit të Bashkimit Evropian?
- A. Austria Polonia, dhe Sllovakia
 - B. Franca, Gjermania dhe Italia
 - C. Greqia, Bullgaria, dhe Hungaria
 - D. Suedia, Norvegjia, dhe Lituania
- 14.** Me cilin shtet ishte e lidhur fuqishëm Shqipëria në Planin e politikës së jashtme gjatë viteve gjashtëdhjeta të shek XX deri më -1978 ?
- A. Me Bashkimin Sovjetik
 - B. Me RSF të Jugosllavisë
 - C. Me Republikën Popullore të Kinës
 - D. Me Republikën e Greqisë
- 15.** Në cilin vit doli Gazeta e parë në gjuhën shqipe në Kosovë “Rilindja”
- A. 1945
 - B. 1946
 - C. 1948
 - D. 1949
- 16.** Cilën nga ngjarjet e historisë antike përshkruan vepra “Iliada” e poetit Homeri?
- A. Luftën e Peloponezit
 - B. Luftën e Mikenës
 - C. Luftën e Trojës
 - D. Luftën e Kretës
- 17.** Greqi antike ishte e ndarë politikisht dhe secila bashkësi e njerëzve kishte ishte e organizuar në një teritor të vogël që ishte qytet-shtet. Si quhej qyteti- shtet në Greqinë antike
- A. Oligarkia
 - B. Polisi
 - C. Bazileusi
 - D. Geruzia
- 18.** E gjithë popullsia e Romës antike ndahej në dy grupe të mëdha: patricë dhe plebejë. Cilës shtresë i takonin plebejt?
- A. Shtresës së ultë që nuk kishte të drejta politike
 - B. Shtresës së ultë që drejtonte tregëtinë
 - C. Shtresës së lartë që kishte të drejta politike
 - D. Shtresës së lartë që drejtonte ekonominë
- 19.** Si ndikoj përhapja e fesë islame në mesin e fiseve arabe?
- A. Në dobësimin e unitetit politik
 - B. Në zhvillimin e politeizmit
 - C. Në zhdukjen e monoteizmit
 - D. Në forcimin e unitetit politik

- 20.** Si quheshin organizatat mesjetare të tregtarëve?
A. Komuna
B. Gilde
C. Esnafe
D. Kallfe
- 21.** Princi Karl Topia në dokumentet e kohës është quajtur me titullin:
A. Zot i gjithë vendit të Arbrit
B. Zot i gjithë vendit të Shqipërisë
C. Sundimtar i gjithë vendit të Ilirisë
D. Sundimtarë i gjithë vendit të Epirit
- 22.** Durrësi ishte kryeqendra e Mbretërisë Ilire të:
A. Dardanëve
B. Molosëve
C. Taulantëve
D. Ardianëve
- 23.** Janë dhënë pohimet:
I. Pasardhës të Sllavëve të jugut janë: sllovenët, kroatët, serbët, malazezët, maqedonët dhe bullgarët
II. Pasardhës të Sllavëve të jugut janë: çekët, sllovakët dhe polakët
III. Pasardhës të Sllavëve të jugut janë: rusët, bjellorusët dhe ukrainasit
IV. Pasardhës të Sllavëve të jugut janë: rusët, polakët dhe ukrainasit
- Cilat nga pohimet e dhëna është i saktë?
A. Pohimi nën I
B. Pohimi nën II
C. Pohimi nën III
D. Pohimi nën IV
- 24.** Në pashallëkun e Janinës pos shqiptarëve si një grup i madh etnik jetonte edhe cili popull tjetër:
A. Populli bullgar
B. Populli grek
C. Bashkësia etnike serbe
D. Bashkësia etnike malazeze
- 25.** Në dhjetor-janar të 1943-1944 Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës organizoi një mbledhje në të cilën kërkohet bashkimi i viseve të banuara me shqiptarë me shtetin amë. Për vendimet e cilit tubim bëhet fjalë:
A. Lidhjen e Pejës
B. Lidhjen e dytë të Prizrenit
C. Konferencën e Bujanit
D. Kuvendi i Junikut


- 26.** Mbretëria e Ardianëve është themeluar rreth shek.III para Krishtit dhe shtrihej nga Vjosa në jug e deri në Dalmacinë e Mesme në veri .Cili ishte mbreti i parë Ardian ?
- Pirro
 - Longari
 - Bardhyli
 - Agroni
- 27.** Cili ishte Kryetari i parë i Republikës Federale të Gjermanisë të krijuar më 1949?
- Erih Honekeri
 - Konard Adenaueri
 - Vili Brant
 - Helmut Shmidi
- 28.** Me mbështetjen e qeverisë britanike më 17 dhjetor 1920 Shqipëria u pranua në Lidhjen e Kombeve.Cilat shtete kundërshtuan pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve ?
- Mbretëria Serbe-Kroate-Sllovene dhe Mbretëria Greke
 - Mbretëria Serbe-Kroate-Sllovene dhe Italia
 - Italia dhe Mbretëria Greke
 - Franca dhe Rusia
- 29.** Për të bashkuar të gjitha forcat për mbrojtjen dhe çlirimin e tërë krahinave shqiptare Gj.K. Skënderbeu më 2 mars 1444 ftoi Kuvendin e Përgjithshëm në Lezhë. Përveç Skënderbeut kush tjetër nga krerët e rëndësishëm shqiptar morri pjesë në këtë Kuvend?
- Hamza Kastrioti, Gjon Kastrioti
 - Vrana Konti, Moisi Golemi
 - Depë Zenebishi, Gjini Gazuli
 - Andrea Topia,Teodor Muzaka
- 30.** Gjatë Luftës së Parë Botërore Shqipëria u pushtua nga ushtria austro-hungareze,italiane dhe franceze.Në hartën e poshtëshënuar cilën zonë okupuese paraqet hapësira e shënuar me vija vertikale?
- Zonën okupuese Austro-Hungareze
 - Zonën okupuese Franceze
 - Zonën okupuese Italiane
 - Asnjërën zonë



GJEOGRAFI

31. Cila nga format relievore paraqet Fleksurën tektonik:

- A. I
- B. II
- C. III
- D. IV



32. Shkenca e cila merret me studimin e motit quhet:

- A. Klimatologji
- B. Pedologji
- C. Petrologji
- D. Gjeomorfologji

33. Atmosfera është mbështjelli i gaztë i tokës, sa është pjesëmarrja e Oksigjenit në të:

- A. 11 %
- B. 21 %
- C. 31 %
- D. 41 %

34. Si quhen vijat në hartat meteorologjike që bashkojnë vendet me Shtypje të njëjta atmosferike;

- A. Izonefe
- B. Izohjete
- C. Izobare
- D. Izoterme

35. Cili kontinent ka numrin e banorëve më të madhe:

- A. Azia
- B. Evropa
- C. Afrika
- D. Amerika veriore

36. Cila alternativë është e saktë:

- A. Kina, Pekini, Danubi, Muri Kinez
- B. Egjipti, Kajro, Nili, Piramida
- C. Shqipëri, Tirana, Vardari, Dajti
- D. Britani e madhe, Berlioni, Temza, Big Beng

37. Gjiri i Meksikës gjendet në mesë:

- A. Amerikës Veriore – Azisë
- B. Amerikës Jugore – Afrikës
- C. Amerikës Jugore – Australisë
- D. Amerikës Veriore – Amerikës Jugore

- 38.** Struktura ekonomiko-sociale e popullsisë përbëhet nga:
- A. Mosha, profesioni dhe sektori i pronësisë
 - B. Gjinia, profesioni dhe sektori i pronësisë
 - C. Veprimtaria, profesioni dhe sektori i pronësisë
 - D. Gjinia, profesioni dhe pjelloria
- 39.** Sipas llojit të produktit ose shërbimit që e bëjnë, veprimtarit ekonomike ndahen në tre sektor (primar, sekondar dhe terciar), cili kombinim i takon veprimtarisë sekondare:
- A. Bujqësia, pylltaria, Industria
 - B. Bujqësia, pylltaria, gjuetia
 - C. Pylltaria, gjuetia, Xehetaria
 - D. Xehetaria, industria, ndërtimtaria
- 40.** Importuesi më i madh i naftës në botë është:
- A. ShBA
 - B. Indonezia
 - C. Arabia Saudite
 - D. Norvegjia
- 41.** Cili qytet ka pozitën gjeografike më Veriore:
- A. Tirana
 - B. Shkupi
 - C. Prishtina
 - D. Gjirokastra
- 42.** Liqet e Lurës si atraksion turistik gjenden në:
- A. Kosovë
 - B. Maqedoni
 - C. Mal të zi
 - D. Shqipëri
- 43.** Në cilin nga shtetet, 95% e popullsisë jeton në 5% të territorit?
- A. Francë
 - B. Kina
 - C. Egjipt
 - D. Brazil
- 44.** Cili shtet gjendet në veri të Bullgarisë
- A. Greqia
 - B. Rumania
 - C. Turqia
 - D. Maqedonia
- 45.** Malet Pirineje gjenden në mesë:
- A. Itali-Zvicër
 - B. Austri-Gjermani
 - C. Francë-Spanjë
 - D. Norvegji-Suedi

SOCIOLOGJI

- 46.** Sipas cilit mendimtar, revolucioni shërben si forcë lëvizëse për shembjen e sistemit shoqëror ?
- A. Zh. Ruso
 - B. E. Dyrkemi
 - C. S. Simoni
 - D. K. Marksi
- 47.** Përkufizimi: “ *Sociologjia është shkencë, në kuptimin që ajo nënkupton metodat sistematike të studimit dhe vlerësimin e teorive nën dritën e fakteve dhe argumentimit logjik* ” është:
- A. i pranueshëm dhe i njëanshëm
 - B. i plotë dhe i pjesërishëm
 - C. i pranueshëm dhe i plotë
 - D. i pranueshëm dhe i pjesërishëm
- 48.** Sipas *Platonit* shtetin duhet ta mbrojnë:
- A. Rojtarët
 - B. Filozofët
 - C. Zanatçinjtë
 - D. Robërit
- 49.** Ideologjia radikale për dallim nga ajo konservatore mbështetet në:
- A. vlerat e ruajtjes
 - B. vlera stabile
 - C. vlerat djathtiste
 - D. vlerat e ndryshimit
- 50.** Cila teori bënë interpretimin e kompleksitetit të kulturës përmes fakteve ?
- A. teoria metafizike
 - B. teoria pozitiviste
 - C. teoria kulturaliste
 - D. teoria natyraliste
- 51.** Kombi është:
- A. Bashkësi e madhe njerëzish
 - B. Bashkësi e madhe popujsh
 - C. Bashkësi e vogël fisesh
 - D. Bashkësi klasash
- 52.** Fe monoteiste është:
- A. budizmi
 - B. hinduizmi
 - C. islamizmi
 - D. konfuçianizmi

- 53.** Burokracia paraqet :
- A. shtresën shoqërore të nëpunësve
 - B. elitën intelektuale në një shoqërie
 - C. elitën artistike në një shoqëri
 - D. kastën e privilegjuar në një shoqëri
- 54.** Dinamika dhe statika sociale studiohen nga:
- A. antropologjia
 - B. psikologjia
 - C. sociologjia
 - D. filozofia
- 55.** Martesa zakonore lidhet sipas normave:
- A. religjioze
 - B. shtetërore
 - C. moderne
 - D. tradicionale
- 56.** Në demokraci dominon:
- A. pushteti i oligarkisë
 - B. pushteti i shumicës
 - C. pushteti i pakicës
 - D. pushteti i meritokracisë
- 57.** Teoria mekaniciste pikënisje ka metodat e shkencave natyrore dhe:
- A. emocionalen
 - B. shoqëroren
 - C. ligjshmëritë
 - D. psikikën
- 58.** Shoqëria pasindustriale karakterizohet me punë:
- A. bujqësore
 - B. teknologjike
 - C. industriale
 - D. fizike
- 59.** Pushteti politik kërkesën për dëgjueshmëri e bazon në legjimitet, këtë teori e përfaqëson:
- A. Maks Veberi
 - B. Shën Augustini
 - C. Tomas Kompanella
 - D. Herber Spenseri
- 60.** Determinizimi shpjegohet:
- A. parashikimi i dukurive të ardhme socio-kulturore
 - B. mosvarësia e një dukurie nga dukuria tjetër
 - C. moslidhmëria e shkencave shoqërore me ato natyrore
 - D. çdo dukuri duhet të jet e përcaktuar në raport me një dukuri tjetër

- 61.** Komunikimi si forma më efikase në shkallë të lartë përdorimi, quhet gjuhë :
- A. zhargonesh
 - B. eklektizëmi
 - C. standarde
 - D. mobiliteti
- 62.** Diktatura paraqet:
- A. formë të qeverisjes
 - B. qeverisjen humane
 - C. traditën e pushtetit
 - D. kulturën e shoqërisë
- 63.** Shteti duhet të ketë:
- A. territorin, ekonominë, kulturën
 - B. pushtetin, ekonominë, filozofinë
 - C. ideologjinë, ekosistemin, territorin
 - D. territorin, popullsinë, pushtetin publik
- 64.** Cili ishte botëkuptimi shkencor i Ogyst Kontit ?
- A. Iluminizmi
 - B. Pozitivizmi
 - C. Revolucionimi
 - D. Strukturalizmi
- 65.** E drejta është sistem i rregullave dhe normave të cilat i nxjerrë:
- A. bashkësia
 - B. tradita
 - C. familja
 - D. shteti
- 66.** Forma e pabarazisë shoqërore, të grupet e njerëzve me pasuri ekonomike, që ndikon në mënyrën e tyre të jetës është:
- A. klasa
 - B. kasta
 - C. skllavëria
 - D. shtresa
- 67.** Religjionet emocionale nënkuptojnë avancimin e:
- A. të drejtës dhe zakoneve
 - B. ndjenjave dhe të moralitetit
 - C. të drejtës juridike dhe politike
 - D. të drejtës individuale

- 68.** Normat juridike :
- A. dallojnë nga ato fetare dhe morale
 - B. janë të njëjta me ato fetare dhe morale
 - C. krijohen nga bashkësitë fetare
 - D. krijohen nga bashkësitë zakonore
- 69.** Kush është themelues i teorisë formale të sociologjisë ?
- A. Park
 - B. Sorkin
 - C. Spenser
 - D. Zimel
- 70.** Në kulturën nacionale, nënsistemet e veçanta njihen si:
- A. makrokultura
 - B. etno-kultura
 - C. subkultura
 - D. maskultura

- 71.** _____ studion ndryshimet e sjelljes si rezultat i kalimit te kohes apo te moshes.
- A. Psikologjia Fiziologjike
 - B. Psikologjia e Zhvillimit
 - C. Psikologjia Sociale
 - D. Psikologjia Eksperimentale
- 72.** Mostra zgjedhet prej:
- A. Eksperimentit
 - B. Anketimit
 - C. Populacionit
 - D. Historia e rastit
- 73.** Cila nga fazat ne vijim nuk eshte pjese e procesit te vdekjes?
- A. Procesimi
 - B. Mohimi
 - C. Zemerimi
 - D. Marreveshja
- 74.** Sipas _____ sjelljet e shumellojshme te njerezve kane mundesi te mesohen dhe te pervesohen ne mbeshtetje te vezhgimit te qellimshem te sjelljeve te te tjereve, sidomos te atyre qe i konsiderojme si “model” prej te cileve duhet mesuar.
- A. Teoria e Brunerit per procesin e te mesuarit
 - B. Teoria e Kelerit per procesin e te mesuarit
 - C. Teoria e Bandures per te mesuarit social
 - D. Teoria e Piazhes per procesin intelektual
- 75.** Cila ne vijim nuk jane pjese e etikes se hulumtive psikologjike:
- A. Rreziku minimal per subjekteve
 - B. Konfidencialiteti i informacioneve te mbledhura
 - C. Pajtushmeria e plote e subjekteve
 - D. Informatat demografike te subjekteve sic eshte moshja, gjinia, etj.
- 76.** _____ eshte teresia e faktoreve trashegues, qe shkakton zhvillim te caktuar te organizmit:
- A. Prototipi
 - B. Gjenotipi
 - C. Fenotipi
 - D. Biotipi
- 77.** Pjeset e nje teresie, qe kane perputhje madhesie e trajte shkaktojne lidhje e bashkim ngacmimesh trunore ne nje teresi te dallueshme pershkak te:
- A. Parimit te simetrise
 - B. Parimit te afersise
 - C. Parimit te ngjashmerise
 - D. Parimit te mbylljes

- 78.** Cila nga faktoret ne vijim nuk konsiderohet si e rendesishme ne parandalimin e harreses:
- A. Perseritja sistematike
 - B. Te mesuarit permendesh
 - C. Kuptimi thelbesor i permbajtjeve
 - D. Pauzat e shkurta ne mes te dy permbajtjeve
- 79.** Hemisfera e majte lidhet me hemisferen e djathte nepermjet:
- A. Korteksit
 - B. Hipotalamusit
 - C. Trupit kallor
 - D. Struktures limbike
- 80.** Tek eksperimenti i Pavllovit, Mishi, eshte:\
- A. Stimul i kushtezuar
 - B. Reagim i pakushtezuar
 - C. Stimul i pakushtezuar
 - D. Reagim i kushtezuar